

LIGJI Nr. 05/L-010

PËR AGJENCINË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR AGJENCINË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për krahasim dhe Verifikimin të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia).

Neni 2

Fushëveprimi

Ky ligj ka të bëjë me zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe pronën private komerciale si dhe krahasimin e zgjidhjen e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të marra në Kosovë nga autoritetet serbe para qershorit vitit 1999 dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjenci** - Agjencia Kosovare për krahasim dhe Verifikim të Pronës;

1.2. **Bord** - Bordin Mbikëqyrës i Agjencisë;

1.3. **Sekretaria** – Sekretaria ekzekutive;

1.4. **KKP** - Komisioni për Kërkesa Pronësore;

1.5. **KVVP** - Komisioni për Verifikimin dhe Vendosje për Prona.

1.6. **Ligji NR. 04/L -274** - Ligji nr. 04/L -274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare

në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë / nr.32 / 15 maj 2014).

KAPITULLI II

AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës

1. Agjencia është Agjenci e pavarur e themeluar sipas Nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me mandat të përkohshëm.

2. Përgjegjësitë e Agjencisë janë:

2.1. pranon, krahason dhe përmes KVVP, zgjidh dallimet dhe mos pajtueshmëritë në mes të dokumenteve kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999 të cilat janë marrë në Kosova nga autoritetet serbe dhe të dokumenteve kadastrale aktuale në Republikën e Kosovës, për pronën private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare.

2.2. përmes KKP, zgjidh, kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me luftën në Kosovë, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e saj, në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, të cilat më herët janë dorëzuar në Agjencinë Kosovare për prona, ku parashtuesi i kërkesës aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

2.2.1. kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe

2.2.2. kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.

2.3. të zbatojë vendimet e KKP, KVVP dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore;

2.4. të administroj pronat me kërkesën e parashtuesit të suksesshëm të kërkesës.

2.5. të zbatojë skemën vullnetare të qirasë për pronat nën administrim të Agjencisë.

3. Asgjë në këtë nen nuk i cenon të drejtat e parashtuesve të kërkesave që të ushtrojnë pranë gjykatave kompetente kërkesat që nuk përfshihen në kërkesat e paraqitura në paragrafin 2 të këtij neni dhe ato që nuk janë paraqitur brenda afatit për paraqitjen e kërkesave.

Neni 5

Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia përbëhet nga:

- 1.1. Bordi Mbikëqyrës i Agjencisë;
- 1.2. Sekretaria Ekzekutive;
- 1.3. Komisioni për Kërkesa Pronësore (KKP);
- 1.4. Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP).

Neni 6

Bordi mbikëqyrës i Agjencisë

1. Bordi mbikëqyrës punën administrative të Agjencisë dhe ofron udhëzime për politikën dhe orientimin e përgjithshëm të Agjencisë.
2. Bordi përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Emërimi i anëtarëve të Bordit bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 04/L -274: Dy anëtarë emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas propozimit nga Kryeministri. Tre (3) anëtarë, emërohen nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE). Kryesuesi i Bordit zgjidhet nga Bordi Mbikëqyrës.
3. Anëtarët e Bordit zgjidhen për një mandat tre (3) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes.
4. Asnjë person nuk mund të bëhet apo të mbetet anëtar i Bordit nëse:
 - 4.1. është i dënuar me burgim prej gjashtë muaj apo më shumë, pas një procesi të duhur dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare;
 - 4.2. është përjashtuar apo larguar për sjellje të keqe profesionale gjatë ushtrimit të profesionit të tij ose
 - 4.3. ka interesa që janë në konflikt me përgjegjësitë e tij sipas këtij Ligji.
5. Anëtarët e Bordit largohen nga detyra nga organi i cila i ka emëruar, nëse ai ose ajo:
 - 5.1. e humbë të drejtën për të shërbyer si anëtar i Bordit sipas paragrafit 4 të këtij neni.
 - 5.2. e përdorë postin e tij në mënyrën e cila nuk është në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij zyrtare të përcaktuara me këtë ligj; ose
 - 5.3. shpërfill detyrat e tij sipas këtij ligji.
6. Bordi nuk merr pjesë në procesin përmes të cilit Komisioni i miraton vendimet për kërkesat apo rastet individuale.
7. Anëtarët e Bordit marrin kompensim për pjesëmarrje në mbledhjet e Bordit. Lartësinë e kompensimit e cakton institucioni që i zgjedhë.
8. Rregullat e procedurës dhe parimet e përgjithshme të punës së Bordit mund të rregullohen me akt nënligjor që aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 7 **Sekretaria ekzekutive**

1. Sekretaria ka Drejtorin dhe Zëvendësdrejtorin. Drejtori dhe Zëvendësdrejtori emërohen nga Kuvendi pas propozimit nga Kryeministri me mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.

2. Agjencia tre (3) muaj para skadimit të mandatit të Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Agjencisë informon Kryeministrin në mënyrë që të fillojë procedurën për zgjedhjen e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të ri.

3. Në rast të mbetjes së pozitës së lirë për shkak të dorëheqjes apo arsyeve tjera Bordi do të caktoj ushtruesin e detyrës në përputhje me rregullat nga radhët e të punësuarve në Agjenci në përputhje me ligjet në fuqi.

4. Objekt i krahasimit dhe vendosjes, nëse ka dallime apo mospërputhshmëri, janë dokumentet për prona private, pronën private komerciale dhe pronën private të bashkësive fetare si dhe rastet kur në njërin nga evidencat kadastrale, prona evidentohet si pronë e paluajtshme private.

5. Kriteret për zgjedhjen e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit duke përfshirë edhe mënyrën e zgjedhjes së ushtruesit të detyrës për këto pozita rregullohen me akte nënligjore të nxjerra nga Qeveria.

6. Përgjegjësitë e Sekretarisë përfshijnë mbledhjen dhe regjistrimin e rasteve bazuar në versionin origjinal të skanuar të dokumenteve kadastrale të para Qershorit të vitit 1999 të cilat janë marrë në Kosovë nga autoritetet serbe e të pranuar nga/përmes Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian, krahasimi i tyre me dokumentet kadastrale në Kosovë për të identifikuar dallimet apo mospërputhjet në mes të këtyre dy grupeve të dokumenteve, dhe:

6.1. në rastet kur nuk gjenden dallime apo mospërputhje dosja origjinale e rastit, duke përfshirë edhe vendimin e Sekretarisë, i përcillet Agjencisë Kadastrale të Kosovës;

6.2. në rastet kur gjenden dallimet apo mospërputhjet, njoftohen palët, në emër të cilëve evidentohet prona në dokument kadastral, përpunohet dhe përgatitet rasti dhe i dërgohet për shqyrtim KVVVP-së.

7. Sekretaria do të vazhdon ta mbështes KKP nga neni 8 i këtij Ligji për vendosjen e kërkesave të paraqitura në Agjencinë Kosovare për Prona. Në këtë funksion Sekretaria bënë njoftimin e palëve dhe përgatitjen e kërkesave e përgjigjeve në kërkesa për t'u shqyrtuar nga KKP. Sekretaria ka kompetenca të refuzojë kërkesat që me arsye janë të papranueshme dhe që nuk janë në kuadër të kompetencave të Agjencisë.

8. Detyrat përgjegjësitë dhe organizimi i Sekretarisë mund të rregullohen në detaje me akt nënligjor që aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas propozimit të Sekretarisë, ndërsa procedurat e brendshme të cilat duhet të jenë në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore që nxirren për zbatimin e këtij ligji, miratohen nga drejtori ekzekutiv sipas propozimit nga Sekretaria dhe në konsultim me Bordin.

Neni 8

Komisioni për kërkesa pronësore

1. KKP i themeluar me Ligjin Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale vazhdon të punon dhe të vendosë kërkesat e paraqitura në Agjencinë Kosovare për Prona deri në vendosjen e të gjitha kërkesave të pranuar aktivizohet sipas nevojës dhe paguhet për sesionet e mbajtura.

2. KKP përbëhet nga tre (3) anëtarë. Një anëtarë do të emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës. Mandati aktual i dy (2) anëtarëve ndërkombëtar të KKP-së, të cilët janë emëruar në pajtim me Ligjin 04/L-274 do të vazhdojë sipas kushteve dhe dispozitave të caktuara në vendimin për emërim.

Neni 9

Komisioni për Verifikim dhe Vendosje për Prona (KVVP)

1. KVVP përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Dy (2) nga anëtarët e KVVP emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ndërsa tre (3) nga pesë (5) anëtarët e Komisionit, duke përfshirë një (1) përfaqësues të komuniteteve jo shumicë, emërohen nga PSBE. Kryesuesi i KVVP zgjedhet nga anëtarët e KVVP.

2. Kuvendi, në konsultim me KVVP, mund të themelojë edhe trupa shtesë të KVVP-së, të cilët emërohen në bazë të paragrafit një (1) të këtij neni.

Neni 10

Emërimi dhe shkarkimi nga detyra i anëtarëve të Komisioneve

1. Anëtarët e Komisioneve nga nenet 8 dhe 9 të këtij ligji duhet të jenë profesionistë nga fusha e së drejtës pronësore si dhe të jenë të kualifikuar për të bartur post gjyqësor.

2. Anëtarët e Komisionit emërohen nga autoriteti përkatës për emërim i përcaktuar në nenet 8.2 dhe 9 të këtij ligji për një mandat tre (3) vjeçar dhe mund të riemërohen.

3. Anëtarët e Komisionit mund të shkarkohen nga detyra nga autoriteti përkatës për emërim, i përcaktuar në nenet 8.2 dhe 9 të këtij ligji pas rekomandimit të shumicës së anëtarëve të Komisionit ose për shkak të mos përmbushjes së vazhdueshme dhe të paarsyetuar të detyrave të postit.

4. Anëtari i Komisionit përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë kur ekzistojnë kushtet për përjashtim të parapara më Ligjin mbi procedurën administrative dhe Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

5. Personat me interes ligjor në procedurë mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Komisionit me kërkesë me shkrim drejtuar kryesuesit të Komisionit.

6. Komisioni përkatës vendos për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit.

7. Detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e punës së Komisioneve mund të rregullohen në

detaje me akt nënligjor që aprovohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas propozimit të Sekretarisë.

KAPITULLI III

PËRPUNIMI I KËRKESAVE PRONËSORE DHE VENDOSJA E TYRE NGA KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE

Neni 11

Procedura për përpunimin e kërkesave pronësore

1. Sekretaria e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos parashtruesit të kërkesës, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të mundshme, duke përfshirë edhe njoftimin publik për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë. Në rastet e duhura, përpjekjet e tilla të arsyeshme do të jenë në formë të një lajmërimi në një botim zyrtar të Sekretarisë.

2. Çdo person, përveç parashtruesit të kërkesës, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përafërta, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

3. Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdo qoftë gjatë procedurës.

4. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kopjes së kërkesës, pala pranuese mund t'i dërgojë Sekretarisë përgjigje në kërkesë.

Neni 12

Procedura dhe vendimet e Komisionit për kërkesa pronësore

1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj apo me ndonjë akt nënligjor me të cilën zbatohet ky ligj, dispozitat e Ligjit mbi procedurën administrative zbatohen përshtatshmërisht për procedurat e KKP.

2. Komisioni i merr vendimet në bazë të kërkesës dhe përgjigjes apo përgjigjeve në kërkesë.

3. Komisioni mund të:

3.1. bashkojë ose shkrijë kërkesat me qëllim të shqyrtimit të tyre dhe marrjes së vendimeve lidhur me to kur ka çështje të përbashkëta dhe të qarta ligjore që duhet shqyrtuar;

3.2. ngarkojë stafin e Sekretarisë të caktuar nga drejtori i Sekretarisë për t'i shërbyer Komisionit, që të kryejnë funksionin e shqyrtimit të kërkesave dhe dëshmime të caktuara nën mbikëqyrjen dhe miratimin përfundimtar të Komisionit;

- 3.3. përdorë bazën ekzistuese e të dhënave, programet dhe mjetet tjera elektronike për të përshpejtuar vendimmarrjen dhe
- 3.4. ndërmerr masa të tjera procedurale që i konsideron të duhura për të përshpejtuar vendimmarrjen.
4. Komisioni e refuzon kërkesën në tërësi apo pjesërisht kur:
- 4.1. parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur kërkesë complete në pajtim me procedurat e parapara me këtë ligj;
- 4.2. kërkesa nuk është në kompetencë të Agjencisë;
- 4.3. kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë.
5. Me kërkesë të parashtuesit të kërkesës dhe me rekomandim të Sekretarisë, Komisioni mund të lejojë ndërmarrjen e masave të përkohshme mbrojtëse, duke përfshirë edhe urdhrin e përkohshëm, kur parashtuesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë të pranueshme dhe nëse masat e përkohshme nuk lejohen do të pësojë dëme të riparueshme.
6. Kur është në interes të drejtësisë, Komisioni mund të kërkojë dhe të shqyrtojë parashtesa të tjera me shkrim nga palët apo të mbajë seancë dëgjimore me të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët.
7. Për të gjitha seancat dëgjimore të mbajtura pranë Komisionit mbahet dhe ruhet procesverbali. Në procesverbal përfshihen dëshmitë e dëgjimit.
8. Vendimi i Komisionit për kërkesën është ligjërisht detyrues pa cenuar të drejtën në ankesë sipas nenit 15 të këtij ligji dhe Agjencia i njofton palët për këtë përmes dërgimit të vendimit të Komisionit përkatës.

KAPITULLI IV

KRAHASIMI DHE VERIFIKIMI I DOKUMENTEVE KADASTRALE DHE VENDOSJA E RASTEVE TË MOSPËRPUTHSHMËRISË SË DOKUMENTACIONIT KADASTRAL

Neni 13

Procedura e krahasimit

1. Agjencia do të ketë qasje të plotë pa pagesë në të dhënat kadastrale që mbahen në Agjencinë Kadastrale e Kosovës dhe në të gjitha Zyra Kadastrale Komunale në mbështetje të mandatit të saj.
2. Me marrjen e të dhënave kadastrale Sekretaria do t'i krahasojë ato me të dhënat kadastrale të para vitit 1999 që janë në dosjet e lëndëve për të identifikuar ndonjë zbrazëti në të dhënat kadastrale qoftë në emrin e pronarit, madhësinë dhe formën e pronës apo ndonjë mospërputhje tjetër që mund të ketë në mes të dokumenteve të cilat mund të ndikojnë në pronësinë dhe regjistrimin e pronës në të dhënat kadastrale.

3. Në rastet kur nuk ka dallime apo mospërputhje në mes të të dhënave kadastrale të para vitit 1999 dhe të dhënave kadastrale të marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Zyra Kadastrale Komunale, Sekretaria do t'i përfshijë këto të gjetura në dosjen e lëndës e cila pastaj do t'i dërgohet Agjencisë Kadastrale të Kosovës duke përfshirë edhe vendimin e Sekretarisë.

4. Në rastet kur është gjetur ndonjë dallim apo mospërputhje në mes të të dhënave kadastrale të para vitit 1999 dhe të dhënave kadastrale të marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Zyra Kadastrale Komunale, Sekretaria do të bëjë një krahasim të plotë të dokumenteve me të gjitha arkivat publike që janë në dispozicion dhe përveç kësaj do të bëjë çdo përpjekje të mundshme, duke përfshirë edhe njoftimin publik për ta kontaktuar personin që përmendet në dokumente, trashëgimtarët apo anëtarët e bashkësisë familjare të personit në fjalë që përmenden në dokumente dhe çdo institucioni në Kosovë i cili mund të ketë informata për pronën në fjalë, për të kërkuar dëshmi dhe për të përcaktuar se si ka ardhur deri tek kjo mospërputhje.

5. Për ta informuar çdo person tjetër që aktualisht ushtron të drejtën apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është lëndë e kërkesës Sekretaria do të bëjë përpjekje të mundshme, duke përfshirë edhe njoftimin publik për t'i identifikuar këta persona. Metodologjia e identifikimit të këtyre palëve të interesuara mund të përfshijë identifikimin fizik të pronës apo njoftimin në ndonjë publikim zyrtar nga ana e Sekretarisë. Këto palë të interesuara do të kenë afat prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike për ta informuar Sekretarinë për qëllimin e tyre për të marrë pjesë në procedurën administrative që ka të bëjë me rastin specifik.

6. Personi i cili ka interes ligjor në kërkesë dhe që nuk është njoftuar për rastin, mund të pranohet si palë në çdo fazë të procedurës, deri në kohën kur Komisioni vendos lidhur me rastin.

Neni 14

Vendimet e Komisionit për Verifikimin dhe Vendosjen e Pronës

1. Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë ligj apo me ndonjë akt nënligjor me të cilën zbatohet ky ligj, dispozitat e Ligjit mbi procedurën administrative zbatohen përshtatshmërisht për procedurat e KVVP.

2. Pas analizimit dhe verifikimit të të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me dallimet apo mospërputhshmërinë në mes dokumenteve kadastrale, Sekretaria rastin ia dorëzon, KVVP për vendimmarrje.

3. Komisioni, bazuar në dokumentet e bashkëngjitura në dosjen e rastit, përgjigjes së palëve apo personave të tjerë të interesuar dhe rekomandimin e Sekretarisë, do të përcakton se cilat shënime kadastrale të regjistruara janë të ligjshme, regjistrimi aktual në regjistrat kadastral të institucioneve të Republikës së Kosovës apo regjistrimi në dokumentet e para Qershorit të vitit 1999 të cilat janë marrë në Kosovë nga autoritetet serbe dhe në rastet kur të dhënat kadastrale në Institucionet e Kosovës nuk janë të sakta, Komisioni do të përcaktojë shënimet e ligjshme që duhet regjistruar në të dhënat kadastrale në Kosovë. Me rastin e vendimmarrjes, Komisioni duhet të ketë parasysh vendimet përfundimtare dhe të detyrueshme të institucioneve të autorizuar gjyqësore dhe administrative.

4. Sekretaria ia dërgon vendimin të dy palëve në emër të të cilave ka qenë e regjistruar prona dhe personave të tretë të interesuar të cilët janë kyçur në procedurë para vendosjes së rastit të dallimeve apo mospërputhshmërisë së evidencave kadastrale.

5. Pas kalimit të afatit për ankesë, Sekretaria do ta dërgoj dosjen origjinale Agjencisë Kadastrale

të Kosovës, duke përfshirë vendimin e komisionit.

Neni 15 **E drejta në ankesë**

1. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia për vendimin e KKP mbi kërkesën apo për vendimin e KVVP, çdo palë mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë të Agjencisë.

2. Përveç nëse me këtë ligj apo me ndonjë akt nënligjor me të cilën zbatohet ky Ligj parashihet ndryshe, dispozitat e Ligjit mbi procedurën kontestimore zbatohen përshtatshmërisht në procedurën e ankesës pranë Gjykatës Supreme.

3. Ankesa mund të paraqitet nëse:

3.1. vendimi përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtës lëndore a procedurale; ose

3.2. vendimi bazohet në fakte jo të plota apo në vlerësimin e gabuar të fakteve.

4. Pas marrjes së ankesës, Agjencia përmes Sekretarisë i dërgon kopjen palës ose palëve të tjera dhe ankesën me dosjen e Komisionit lidhur me të ia dërgon Gjykatës Supreme të Kosovës.

5. Pasi të paraqitet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës nga pala, vendimi i Komisionit nuk mund të ekzekutohet derisa rasti të jetë në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Supreme të Kosovës.

6. Sekretaria e Agjencisë, nëse kërkohet i ofron palës së pakënaqur informacione dhe udhëzime lidhur me procedurën që duhet ndjekur në përgatitjen e ankesës drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës.

7. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e kopjes së ankesës, pala apo palët tjera mund të dorëzojnë përgjigje me shkrim në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë së Agjencisë.

8. Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve. Dy (2) anëtarë emërohen në bazë të dispozitave të Ligjit 04/L-274 dhe një (1) anëtar emërohet me propozim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe miratim nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

9. Gjykata Supreme e Kosovës mund të kërkojë rivlerësim ose sqarim të mëtutjeshëm të vendimit ndaj të cilit është parashtruar ankesë, nga Komisioni ose mund të kërkojë asistencë nga Sekretaria për verifikimin e dokumenteve shtesë dërguara nga pala ankuuese.

10. Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga pala, përpos parashtruesit të ankesës të dorëzuar në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni, Gjykata Supreme e Kosovës mund të kërkojë dhe shqyrtojë parashtrësia të tjera me shkrim të dorëzuara nga palët apo të mbajë seancë dëgjimore.

11. Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe

dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Nëse faktet dhe dëshmitë e tilla materiale pranohen, Gjykata Supreme mund të kërkojë vlerësimin dhe vërejtjet e Komisionit për këtë.

Neni 16 **Vendimi mbi ankesën**

1. Gjykata Supreme e Kosovës, sipas rregullit, vendos mbi ankesën bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjykatë dhe të shqyrtuara nga Komisioni përkatës.

2. Gjykata Supreme, në bazë dëshmime të paraqitura mund të vendosë mbi faktet e vlerësuara nga Komisioni përkatës.

3. Gjykata Supreme:

3.1. e pranon ankesën dhe merr vendim të ri me ndryshimet që mund të kërkojnë në vendimin e Komisionit përkatës;

3.2. e refuzon ankesën si të papranueshme për arsye procedurale ose

3.3. e refuzon ankesën si të pabazuar dhe e konfirmon vendimin e Komisionit përkatës.

4. Gjykata Supreme e Kosovës mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni përkatës, në pajtim me nenin 12. paragrafi 3.1 të këtij ligji.

5. Gjatë interpretimit të këtij ligji apo ndonjë akti nënligjor me të cilin zbatohet ky ligj, Gjykata Supreme e Kosovës mund t'i merr parasysh dispozitat e ligjit në fuqi lidhur me kompetencat e Gjykatës Supreme për procedurat civile, me ndryshimet apo kualifikimet e tilla që i konsideron të nevojshme apo të duhura në rrethanat përkatëse.

6. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës janë të formës së prerë e të plotfuqishme dhe nuk mund të kundërshtohen përmes mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme.

7. Vendimin e marrë nga Gjykata Supreme lidhur me ankesën kundër vendimit të KKP Agjencia ua dërgon palëve përmes Sekretarisë.

8. Vendimin e marrë nga Gjykata Supreme lidhur me ankesën kundër vendimit të KVVP, Agjencia ua dërgon palëve dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, përmes Sekretarisë.

KAPITULLI V **EKZEKUTIMI I VENDIMEVE**

Neni 17 **Ekzekutimi i vendimeve**

1. Vendimi i Komisionit përkatës ekzekutohet tridhjetë (30) ditë pas datës së njohimit të palëve

për vendimin nëse në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk parashtrohet ankesë.

2. Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës ekzekutohet tridhjetë (30) ditë pas njoftimit të palëve mbi vendimin.

3. Agjencia vazhdon të bëjë ekzekutimin edhe të vendimeve të pa ekzekutuara të Komisionit përkatës për Kërkesa Pronësore, Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të nxjerra sipas ankesës kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore të cilat nuk janë ekzekutuar nga Agjencia Kosovare për Prona apo nga Drejtorisë për Kërkesa Pronësore Banesore. Gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave ekzekutive Agjencia ka të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe kompetencat të cilat i ka pas Agjencia Kosovare për Prona.

Neni 18

Mjetet juridike

1. Mjetet juridike për ekzekutimin e vendimit mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në dëbimin, vendosjen e pronës nën administrim, marrëveshjen për qiradhënie, konfiskimin dhe shkatërrimin e strukturave të paligjshme, ankandin dhe kërkesa për regjistrimin në regjistrin e te drejtave te pronës se paluajtshme.

2. Para shfrytëzimit të mjetit juridik konfiskimi dhe shkatërrimi i strukturave të paligjshme, mund të shfrytëzohet ndërmjetësimi si mjet për zbatimin e vendimit.

Neni 19

Dëbimi

1. Në rast se vendimi ka të bëjë me dëbimin e personave, Agjencia ia dërgon vendimin poseduesit aktual të pronës kontestuese me të cilin vërtetohet urdhri për dëbim.

2. Vendimi me të cilin vërtetohet urdhri për dëbim zbatohet pas dorëzimit të tij. Urdhri për dëbim mund të zbatohet kundër çdo personi që ndodhet në atë pronë në kohën e dëbimit.

3. Dëbimi zbatohet nga nëpunësi përgjegjës i Agjencisë me ndihmën e organeve për zbatimin e rendit dhe ligjit. Ky nëpunës dhe organet duhet ta kenë flet urdhëresën e nënshkruar nga drejtori i Sekretarisë.

4. Gjatë zbatimit të urdhrin për dëbim, çdo person që nuk u përmbahet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për t'u larguar nga prona mund të largohet nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit. Në rast se gjatë ekzekutimit të urdhrin për dëbim largohet pasuria e luajtshme, Agjencia duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të zvogëluar rrezikun e dëmtimit apo të humbjes së kësaj pasurie.

5. Agjencia e njofton kërkuesin dhe personin i cili e posedon pronën lidhur me datën e caktuar për dëbim. Pas zbatimit të urdhrin për dëbim, nëse kërkuesi nuk është i pranishëm për ta marrë pronën në posedim të menjëhershëm, nëpunësi përgjegjës e plumbon pronën dhe e njofton kërkuesin.

6. Nëse prona ri uzurpohet brenda shtatëdhjet e dy (72) orëve pas kohës së përmbarimit të urdhëresës për dëbim, pas njoftimit nga pashtuesi i kërkesës për ri uzurpimin e kundërligjshëm të pronës Agjencia do ta ri përmbaroj atë edhe një herë përmes ri dëbimit të uzurpuesit nga prona bazuar në urdhëresën e re të lëshuar, duke i respektuar procedurat e paragrafit 3-5 të këtij neni. Për ri dëbim, Agjencia do ta informon paraqitësin e kërkesës për ditën e ri dëbimit dhe do ta fton të jetë i pranishëm gjatë ri dëbimit. Nëse parashtuesi i kërkesës apo i autorizuari i tij/saj dështon të merr pjesë në ri dëbim, Agjencia do ta përmbaron dëbimin dhe do të lëshon vërtetim të ri posedimit.

7. Për çdo ri uzurpim pasues të pronës se njëjtë, do të zbatohen rregullat e procedurave të përgjithshme të përmbarimit bazuar në të njëjtin vendim/aktgjykim dhe urdhër dëbimi si dokumente përmbaruese.

Neni 20

Regjistrimi i vendimeve të KVVP-së në regjistrat kadastral

Vendimi i plotfuqishëm i KVVP-së apo Vendimi sipas ankesës i nxjerr nga Gjykata Supreme e Kosovës, nga sekretaria ekzekutive u dërgohet palëve dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës e cila do të përditëson kadastrën në Kosovë bazuar në këto vendime përfundimtare. Në këtë aspekt shpenzimet paguhet vetëm nga bartësi i të drejtës pronësore/pronari me rastin e lëshimit të të dhënave kadastrale të përditësuara.

KAPITULLI VI

ADMINISTRIMI I PRONAVE DHE ZBATIMI I SKEMES VULLNETARE TË QIRASË

Neni 21

Pronat nën administrimin e Agjencisë

1. Agjencia mund të vendosë të marr nën administrim pronat e pa luajtshme në cilëndo prej rrethanave të mëposhtme:

1.1. me marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e kërkesës;

1.2. me kërkesën e paraqitësit të kërkesës, duke e ndjekur vendimin e Komisionit që vërteton të drejtën pronësore të kërkuarit;

1.3. mbas largimit të banuesit aktual, në rast se kërkuari nuk mund ta ri posedojë pronën pas njoftimit për përmbarimin e largimit nga prona;

2. Për kohën deri sa prona të jetë nën administrimin e Agjencisë (më tej "*prona nën administrim*"), të drejtat e posedimit të pronarit ose të bartësit të së drejtës së banimit pezullohen.

3. Pronat nën administrim Agjencia mund të jepë me qira. Pronat të cilave u dihet pronari apo bartësi i të drejtës së pronësisë mund të jepen me qira vetëm pas pëlqimit të pronarit/bartësit të së drejtës së shfrytëzimit. Të ardhurat nga qiraja e pronës së braktisur private dhe shoqërore regjistrohen në një llogari të veçantë në ruajtje për pronarin e vërtetë ndërsa për pronat të cilave u dihet pronari apo bartësi i të drejtës së pronësisë qiraja i paguhet pronarit/bartësit të së drejtës së shfrytëzimit. Agjencia në emër të shpenzimeve të shërbimeve i mbanë 10% nga shuma e qirasë;

4. Agjencia mund të lëshojë urdhër për largim nga prona nën administrim gjatë çdo kohe sipas rrethanave të mëposhtme:

4.1. kur banuesi aktual nuk pranon të lidhë kontratë të qirasë apo nuk i plotëson kushtet e kontratës së qirasë.

4.2. kur prona është uzurpua në mënyrë të kundërligjshme.

4.3. kur pronari kërkon ri-posedimin e pronës.

5. Pronari ose bartësi i të drejtës së pronës nën administrim mund ti paraqesë kërkesën Agjencisë për kthimin e posedimit të pronës. Pas pranimit të kërkesës së pronarit ose të bartësit të të drejtës për banim, dhe në pajtueshmëri me dispozitat e kontratës së qirasë të lidhur nga Agjencia, Agjencia ia lëshon banuesit aktual urdhrin për largim nga prona duke kërkuar nga ai që ta lirojë pronën në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin dhe nëse banuesi aktual apo qiramarrësi nuk e liron pronën vullnetarisht, Agjencia e lëshon urdhrin me të cilin e autorizon ekzekutimin e largimit nga prona. Administrimi i një prone nga ana e Agjencisë përfundon me ri-posedimin e pronës nga pronari ose bartësi i së drejtës së banimit.

6. Agjencia bën përpjekje të arsyeshme për ta minimizuar rrezikun e dëmtimit të çdo prone nën administrimin e saj. Agjencia nuk mban kurrfarë përgjegjësie për asnjë dëmtim të pronës nën administrimin e saj dhe as për humbjen a dëmtimin e përmbajtjeve të saj.

7. Agjencia administron pronat dhe zbaton skemën e qirasë sipas këtij neni, më së largu deri tetëmbëdhjetë (18) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

8. Agjencia ka obligim t'i informon të gjithë bartësit e të drejtës pronësore apo të drejtës së posedimit, të cilët e kanë lënë pronën nën administrim të Agjencisë dhe në skemën e qirasë, për afatin e fundit të administrimit të pronës së tyre nga Agjencia si dhe për afatin e ushtrimit të kërkesës për ri posedimin e pronës apo kërkesës për mbylljen e lëndës.

KAPITULLI VII DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 22

Bartja e Kompetencave tek Agjencia

1. Autoriteti për të administruar pronat banesore që më parë e ka pasur Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore, i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 për themelimin e Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore, do t'i bartet Agjencisë.

2. Autoriteti për të administruar pronat banesore, komerciale dhe bujqësore pas kërkesës së suksesshme të paraqitur në Agjencinë Kosovare të Pronës të themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10 të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut dhe me Ligjin e Kuvendit të Kosovës Nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e Kërkesave që Lidhen me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën bujqësore dhe atë komerciale, do t'i bartet Agjencisë.

3. Autoriteti për të udhëhequr skemën vullnetare të qirasë të themeluar nga Agjencia Kosovare

e Pronës, do t'i bartet Agjencisë.

4. Agjencia do të ushtrojë autoritetin ekzekutiv lidhur me çdo vendim apo urdhër dëbimi të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore që nuk është ekzekutuar nga Agjencia Kosovare e Pronës. Në ushtrimin e këtij autoriteti ekzekutiv, Agjencia do të ketë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe autoritetin që ka pasur Agjencia Kosovare e Pronës.

5. Agjencia merr përsipër përgjegjësitë e Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 mbi kthimin e të drejtave të banimit për banesat shoqërore të humbura si rezultat i diskriminimit. Dispozitat e saj do t'i zbatojë në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia për llogaritjen e shumave sipas nenit të cekur në këtë paragraf.

Neni 23

Bartja e asetëve, obligimeve kontraktuale dhe buxhetit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, asetet fizike të Agjencisë Kosovare për Prona dhe asetet që më parë i janë bartur Agjencisë Kosovare për Prona nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore, do t'i barten Agjencisë.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga të gjitha kontratat e lidhura nga Agjencia Kosovare për Prona dhe të drejtat dhe obligimet kontraktuale të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore që më parë i janë bartur Agjencisë Kosovare për Prona, do t'i barten Agjencisë.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, ndarjet buxhetore nga Buxheti i Kosovës për Agjencinë Kosovare të Pronës do t'i barten Agjencisë bashkë me çdo ndarje buxhetore që rrjedh nga ky Ligj. Fondet e donatorëve të ndara për Agjencinë Kosovare të Pronës do t'i barten Agjencisë më anë të marrëveshjes me shkrim të Qeverisë dhe organizatës donatore përkatëse.

Neni 24

Bartja e personelit dhe vazhdimi i emërimeve

1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, personeli i Agjencisë Kosovare të Pronës do të bartet në Agjenci për aq kohë sa pozita e tyre të jetë ende e nevojshme në Agjenci. Agjencia, brenda tre (3) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji do t'i zyrtarizoj obligimet kontraktuese me personelin e bartur.

2. Të gjithë personat e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës sipas Ligjit Nr. 03/L-079 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, vazhdojnë të qëndrojnë në postet e tyre deri në skadimin e afatit për të cilin janë emëruar dhe ata persona të emëruar do të veprojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Ndërkombëtarët e emëruar në Bord, Sekretari dhe në trupin gjykues të Gjykatës Supreme të bëra në pajtim me Ligjin 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë do të vazhdojnë derisa ata nuk zëvendësohen me emërimet e bëra në harmoni me këtë ligj dhe persona e emëruar do të veprojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

4. Ndërkombëtarët e emëruar në Komisionin për Kërkesa Pronësore të bëra në pajtim me Ligjin 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të Ligjit në Kosovë do të vazhdojnë deri në skadimin afatit për të cilin janë emëruar dhe persona e emëruar do të veprojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Anëtarët ndërkombëtar nuk do të marrin kompensim nga Buxheti i Kosovës për punën e tyre si anëtar të Bordit.

6. Anëtarët dhe gjykatësit ndërkombëtarë të emëruar në pajtim me Ligjin 04/L-274 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të Ligjit në Kosovë dhe me këtë ligj vazhdojnë të marrin pagën e tyre të specifikuar sipas kushteve të emërimit të tyre.

Neni 25

Kërkesat e parashtruara pranë gjykatave

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për çdo kërkesë nga neni 4.2 i këtij ligji që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para themelimit të Agjencisë.

Neni 26

Rregullat e aplikueshme deri në miratimin e akteve të reja

Shtojcat I, II dhe III, të Ligjit nr. 03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, vazhdojnë të jenë në fuqi deri në nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 27

Buxheti i Agjencisë

Agjencia përgatit dhe menaxhon buxhetin në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 28

Pagat dhe kompensimet

1. Pagat dhe shtesat për nëpunësit e Agjencisë bazohen në kushtet e veçanta nën të cilat ata kryejnë detyrat dhe funksionet.

2. Pagat themelore dhe çdo shtesë për nëpunësit e Agjencisë përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 29

Pranimi i donacioneve

Agjencia mund të pranojë donacione shtesë nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë, për të cilat njoftohet Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të cilat nuk ndikojnë në pavarësinë

financiare të Agjencisë dhe nuk janë në kundërshtim me ligjin dhe që nuk ndikojnë në pavarësinë e Agjencisë ose në të drejtat e saj prej Buxhetit të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 30 Zbatimi

Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Agjencisë, nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 31 Shfuqizimet

1. Pas hyrjes në fuqi, ky ligj shfuqizon:

1.1. Ligjin nr. 03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale i ndryshuar dhe plotësuar me nenin 5 të Ligjit Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

1.2. Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

1.3. Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

1.4. Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 mbi kërkesat pronësore dhe banesore dhe rregullat e procedurës dhe provave të drejtorisë për çështje pronësore dhe banesore si dhe të komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

1.5. Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 për themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore.

Neni 32 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-010
9 qershor 2016**

Shpallur me dekretin Nr. DL-038-2016, datë 28.10.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.